



Pranimi / Doretuar Priljetim/Produkt Received/Delivered		12.07.2023	3	with grad Vitet
Organ / Shënia Organ / Jedinita Org / Unit	Id Prot Id Prot Prot No	Shënia Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKIMSHUK	5170/2023		1/4	



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.810/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri -Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.810/2023 të datës 05.06.2023 të parashtruar nga ankuesi [] me adresë: [] numër [] në Komunën e Prishtinës, kundër organit të punësimit, Agjencia Kadastrale e Kosovës, në çështjen juridike “Kërkesë nga Marrëdhënia e Punës” duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 12.07.2023, morri këtë:

V E N D I M

HEDHET POSHTË si e palejuar ankesa me numër A.nr.810/2023 e datës 05.06.2023 e parashtruar nga ankuesi []

A r s y e t i m

Ankuesi [] i punësuar në Agjencinë Kadastrale të Kosovës, sipas Akt Emërimit të datës 11.01.2012 në pozitën e punës “Shef i Sektorit për Matje” në Sektorin e Matjes, me datën 05.06.2023 ka parashtruar ankesë me numër të protokollit 4582/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër të protokollit Nr.01/508/23 të datës 22.03.2023 të zv Drejtorit të Përgjithshëm në Agjencinë Kadastrale të Kosovës, me pretendimin ankimor se vendimi i Drejtorit të Përgjithshëm në Agjencinë Kadastrale të Kosovës, me të cilin [] është emëruar në pozitën e Drejtorit të Drejtoratit të RDPP-së është emërim i kundërligjshëm.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 08.06.2023 ka

dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Agjencia Kadastrale e Kosovës. Ndërsa Këshilli me datën 16.06.2023, ka pranuar përgjigjen në ankesë, së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka Administruar këto Prova: Ankesë me numër protokollit 4582/2023 te dates 05.06.2023 te parashtruar nga ankuesi ne Keshillin e Pavarur Mbikqyres perSherbim Civil te Kosoves; Emailin e dates 03.04.2023 te drejtuar Emailin e d ates 27.03.2023 te drejtuar Vendimin me numer 3135/2023 te dates 27.05.2023 te kryetarit te Keshillit te Pavarur Mbikqyres persherbim Civil te Kosoves; Raportin e monitorimit me numer te protkollit 3135/2023 te dates 27.05.2023; Akt emerimin e dates 11.01.2012 te ankuesit; Autorizimin e dates 28.04.2023; Kerkesen per pergjigje ne ankesa te dates 08.06.2023; Pergjigjen ne ankesa te dates 16.06.2023; Emalin e dates 03.05.2023 te drejtuar Emalin e d ates 03.04.2023 te drejtuar Emalin e d ates 03.04.2023 te drejtuar A.Ahmeti; Akt emermin e dates 02.03.2015; Vendimin me numer A.nr.545/2023 te Keshillit te Pavarur Mbikqyres persherbim Civil te Kosoves; Vendimin me numer 01/449/2023 te dates 15.03.2023 te Ministrit te Ministrise se Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor dhe Infrastruktures; Vendimin me numer 01/508/2023 te dates 22.03.2023 te Zv Drejtorit te Pergjithshem ne Agjencine Kadastrale te Kosoves; Akt erminin nen shenjen AE.Nr.01/2022 te dates 01.08.2022; Pergjigjen me numer 02/170/2023 te dates 02.03.2023 te Menaxheres se Burimeve Njerezore; Vendimin me numer 01/1188/16 te dates 23.09.2016 te Drejtorit te Pergjithshem ne Agjencine Kadastrale te Kosoves; Vendimin me numer 14/15 te dates 21.12.2015 te Drejtorit te Pergjithshem ne Agjencine Kadastrale te kosoves; Vendiminme numer 46 te dates 20.06.2018; Vendiminme numer 60/2017 te dates 23.10.2017; Vendimin me numer 229/2017 te dates 23.05.2017; Emalin e dates 14.06.2018 te drejtuar Shkresen e me numer te protokollit 01/71/2017 te dates 19.01.2017; Kerkesen me numer te protkollit 01/11/17 te dates 10.01.2017; Shkresen me nuemr te protkollit 01/247/2017 te dates 15.02.2017; Emailin e d ates 28.10.2016 te drejtuar Emailin e dates 30.09.2015 te drejtuar Emailin e d ates 27.04.2016 te drejtuar Emailin e d ates 27.04.2016 te drejtuar Vendimin me nuemr 01/15 te dates 27.02.2015 te Kryeshefit Eksekutiv ne agjencin Kadastrale te Kosoves; Emailin e d ates 11.05.2023 te DMZP-së drejtuar Menaxhereve te Burimeve Njerezore; Akt emerimin e d ates 11.01.2012 te ankuesit;

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke i shqyrtuar të gjitha provat e lëndës ka konstatuar që ankesa e ankuesit është e palejuar, sepse:

Bazuar në shkresat e lëndës rezulton se ankuesi i punësuar në Agjencinë Kadastrale të Kosovës, sipas Akt Emërimit të datës 11.01.2012 në pozitën e punës "Shef i Sektorit për Matje". Ankuesi me datë 27.04.2023 përmes emalit zyrtar ka kërkuar nga, Zv Drejtori i Përgjithshëm në Agjencie Kadastrale të Kosovës që të rishikoj vendimin mbi emërimin e si zëvendësues në Drejtorinë e Drejtoratit të Pronave të Paluajtshme. Ndërsa Zv Drejtori i Përgjithshëm në Agjencinë Kadastrale te Kosovës, me datën 03.05.2023 i është përgjigjur kërkesës se ankuesit se lidhur me procedurat e emërimit të përkohshëm dhe zëvendësimeve, ku bazuar ne dispozitat e ligjore dhe pas



rekomandimeve të tilla është nxjerr vendimi mbi emërimin e përkohshëm andaj per kete ceshtje mund te konsultoni me Menaxherin e Personelit.

Ankuesi i pakënaqur me Vendimin me numër të protokollit Nr.01/508/2023 të datës 22.03.2023 të Zv Drejtorit tePergjithshem ne Agjencine Kadastrale te Kosoves, lidhur me caktimin e ne poziten e punes Zevendesues i Drejtorit te Drejtoratit te RDPP-së, me datën 05.06.2023 parashtron ankese me numër protokolli 4582/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me pretendime ankimore se cituar; *Vendimi me numer Nr.01/508/2023 i Zv Drejtorit te Pergjithshem ne Agjencine Kadastrale te Kosoves, ka shkelje ligjore me qenese se emerimi i eshte bere duke mos u respektuar fare rregullorja QRK.26/2020 i zevendesuar me rregulloren QRK.10/2022 per klasifikimin e vendeve te punes ne sherbim civil, ku sipas nenit 7 jane te caktuara kriteret e pershkrimit te pergjithshem per pune ne kategorine Drejtues i Mesem, po ashtu jane te percaktuara dhe kriteret per Kerkesat e Pergjithshem Formale ku kerkohet diploma e studimeve me te pakten 240 kredi/ ECTS apo ekuivalente me to ndersa ne rastin konkret me emerimin e lartecekur jane bere tejkalime te ankuesi ne teresi duke tejkaluar te njejtin i cili ka me shume se 240 kredi.* Duke kerkuar nga Keshilli i Pavarur qe te aprovohet ankesa e ankuesit si e bazuar dhe te anulohet ne teresi vendimi lidhur me emerimin e Zevendesuesit te Drejtorit te pronave te Palujtshme si i kunderligjshem , duke u obliguar Agjencia Kadastrale e Kosoves qe te shpall konkurs per poziten e Drejtorit te Drejtoratit te Pronave te Palujtshme.

Lidhur me pranueshmërinë e ankesës së ankuesit, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka analizuar dispozitat ligjore në fuqi, duke konstatuar se me nenin 24 paragrafin 3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përcaktohet se: *“Nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankese drejtpërdrejt në KPMSHCK për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil sipas këtij ligji”.* *“E drejta e ankimit në KPMSHCK i njihet edhe çdo kandidati në një procedurë pranimit në Shërbimin Civil. Pas shterimit të drejtës së ankimit në KPMSHCK, mund të iniciohet konflikt administrativ në Gjykatën kompetente për çështjet administrative”*, ndërsa se kush konsiderohet palë në procedurën administrative, Kolegji i’u referua nenit 14 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *“1. Palë në procedurën administrative mund të jetë çdo person fizik, person juridik apo grup personash me një interes të përbashkët: 1.1. me kërkesë të të cilit organi publik ka filluar procedura administrative; 1.2. ndaj të cilit ka filluar procedura administrative apo të cilit rezultati i procedurës administrative mund t’i cenojë të drejtat apo interesat juridike. 2. Palë në procedurën administrative janë, gjithashtu, dhe mbrojtësit e interesave publike të autorizuar me ligj të veçantë, si dhe mbrojtësit e interesave kolektive apo të interesave të gjera të publikut, nëse këto interesa mund të cenohen nga rezultati i procedurës administrative”.* Ndërsa me nenin 124 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përcaktohet legjitimimi, shkaqet dhe mjetet juridike administrative, ndërsa paragrafi 1 i këtij neni përcakton që: *“Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim. Anëtar i një organi kolegjal, ka gjithashtu të drejtën të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi procedural të organit kolegjal, nëse pretendon se një nga dispozitat e neneve 37-43 të këtij Ligji janë shkelur nga një veprim apo mosveprim i tillë, kështu që Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, vlerëson se me Vendimin me*

numër të protokollit Nr.01/508/2023 të datës 22.03.2023, të kundërshtuar me ankese, nuk i është cenuar ndonjë e drejtë apo interes juridik i ankuesit, rrjedhimisht ankuesi nuk ka legjitimitetin e palës për të parashtruar ankesës kundër Vendimit me numër të protokollit Nr.01/508/2023 të datës 22.03.2023 të Zv. Drejtorit të Përgjithshëm në Agjencinë Kadastrale të Kosovës, kështu që bazuar në këtë konstatim si dhe në mbështetje të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, rrjedh se ankesa me numër A.nr.810/2023 dhe numër të protokollit 4582/2023 e datës 05.06.2023 e parashtruar nga ankuesi neprmet perfaqesuesit me autorizim avokat është e pa pranueshme.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.810/2023.

Ilire MEHMETI-SHAQIRI

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Përfaqesuesit me autorizim avokat
- Njësisë së Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kadastrale të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

